REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
DREJTORIA E PRONAVE PUBLIKE DHE ASETEVE
SEKTORI I STEHIMIT

Nr. 6174 prot Maliq më 20/10/2026

PROJEKT VENDIM - NR. 7
PËR
MIRATIMIN E PËRFITUESVE NGA PROGRAMI "SUBVENCIONI I INTERESAVE TË KREDISË", PËR STREHIM

Bazuar ligjit nr.139/2015 "*Për Vetëqeverisjen Vendore*", i ndryshuar, ligjit nr.22/2018 "*Për Strehimin Social*", i ndryshuar me ligjin nr. 48/2023, VKM nr.384, datë 12.6.2019 "*Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore*", VKM nr.453, datë 03.07.2019 "*Për masën e subvencionit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet, që përfitojnë banesë me kosto të ulët , me kredi të lehtësuara nga shteti*", ndryshuar me vendimin nr. 268, datë 29.4.2022, VKM nr.301 datë 15.4.2020 "*Për normat e strehimit, si dhe kushtet e standardet për banesat sociale me qira që blihen në treg dhe banesat me kosto të ulët*", VKB nr. 139, datë 26.11.2025 "*Për miratimin e sistemeve të pikëzimit për programet e strehimit social dhe përcaktimin e nivelit maksimal të subvencionit të qirasë*", VKB nr.91 datë 31.08.2023 për "*Miratimin e rregullores për përbërjen dhe funksionimin e komisionit të strehimit në bashkinë Maliq*", Urdhërin e Kryetarit të Bashkisë nr.158 datë 26.03.2024 "*Për ngritjen e komisionit të strehimit pranë bashkisë Maliq*" si dhe Vendimin nr.04 datë 14.04.2026 të Komisionit të Strehimit bashkia Maliq, mbi "*Miratimin e përfituesve nga programi subvencioni i interesave të kredisë për strehim*", Këshillit të Bashkisë i

PROPOZOJMË

1. Të miratojë familjen me kryefamiljar Z. Ilir Shaban Ahmeti, si përfitues të programit "Subvencioni i Interesave të Kredisë", për Strehim, sipas tabelës Nr.1 bashkëngjitur këtij Projekt-Vendimi.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Zyra e Strehimit, Bashkia Maliq.

3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit nr.139/2015 "*Për Vetëqeverisjen Vendore*" i ndryshuar.

	(Emër Mbiemër)	Nënshkrimi	Data
Konceptoi Përgj.Sektori Strehimi :	L. Mullalli		Dt. 20/10/2026
Miratoi Drejtori i Drejtorisë:	J.Sulo		Dt. 20/10/2026

KRYETARI I BASHKISË
Gëzim Topçiu

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALIQ

Tabela Nr.1 Lista e përfituesve të programit të Strehimit Social, Subvencioni i Interesave të Kredisë

Nr	Emri/Atësia /Mbiemri *(kryefamiljari)*	Pikë	Përbërja familjare	Struktura e apartamentit që përfiton	Kushtet e Strehimit (shkronja "a", e nenit 16)	Kushtet familjare (shkronja "b", e nenit 16)	Kushtet sociale (shkronja "c", e nenit 16)	Të ardhurat mujore neto të familjes/lekë	Punësimi	Kredia Maksimale që përfiton	Kontakt
1	Ilir Shaban Ahmeti	30	5	3+1	Nuk ka banesë në pronësi	Familje e re	Minoriteti Egjiptjan	101400 lekë/muaj	Privat	2,835,600 lekë	06953555126

	(Emër Mbiemër)	Nënshkrimi	Data
Konceptoi Përgj.Sektori Strehimi :	L. Mullalli		Dt. 20/10/2026
Miratoi Drejtori i Drejtorisë:	J.Sulo		Dt. 20/10/2026

KRYETARI I BASHKISË
Gëzim Topçiu

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALIQ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
DREJTORIA E PRONAVE PUBLIKE DHE ASETEVE
SEKTORI I STEHIMIT

6124

Maliq më 20 / 10 /2026

RELACION
MBI PROJEKT-VENDIMIN
PËR
MIRATIMIN E PËRFITUESVE NGA PROGRAMI "SUBVENCIONI I INTERESAVE TË KREDISË", PËR STREHIM

Bazuar ligjit nr.139/2015 "*Për Vetëqeverisjen Vendore*", i ndryshuar, ligjit nr.22/2018 "*Për Strehimin Social*", i ndryshuar me ligjin nr. 48/2023, VKM nr.384, datë 12.6.2019 "*Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore*", VKM nr.453, datë 03.07.2019 "*Për masën e subvencionit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet, që përfitojnë banesë me kosto të ulët , me kredi të lehtësuara nga shteti*", ndryshuar me vendimin nr. 268, datë 29.4.2022, VKM nr.301 datë 15.4.2020 "*Për normat e strehimit, si dhe kushtet e standardet për banesat sociale me qira që blihen në treg dhe banesat me kosto të ulët*", VKB nr. 139, datë 26.11.2025 "*Për miratimin e sistemeve të pikëzimit për programet e strehimit social dhe përcaktimin e nivelit maksimal të subvencionit të qirasë*", VKB nr.91 datë 31.08.2023 për "*Miratimin e rregullores për përbërjen dhe funksionimin e komisionit të strehimit në bashkinë Maliq*", Urdhërin e Kryetarit të Bashkisë nr.158 datë 26.03.2024 "*Për ngritjen e komisionit të strehimit pranë bashkisë Maliq*" si dhe Vendimin nr.04 datë 14.04.2026 të Komisionit të Strehimit bashkia Maliq, mbi "*Miratimin e përfituesve nga programi subvencioni i interesave të kredisë për strehim*".

Në zbatim të legjislacionit në fuqi për strehimin social dhe akteve nënligjore përkatëse, është shqyrtuar aplikimi i familjes me kryefamiljar Z. Ilir Shaban Ahmeti, për përfitim nga programi "Banesë me Kosto të Ulët nëpërmjet Subvencionimit të Interesave të Kredisë".
Aplikimi është paraqitur në sistemin online të strehimit me nr. BS061020260007, datë 06.10.2026 dhe është shoqëruar me dokumentacionin përkatës, i cili është verifikuar nga strukturat përgjegjëse të Bashkisë Maliq.

Nga dokumentacioni i paraqitur rezulton se familja nuk disponon banesë në pronësi, nuk ka banesë në proces legalizimi dhe nuk ka kryer transaksione pronësie gjatë 5 viteve të fundit. Ky konstatim mbështetet në vërtetimet përkatëse të pronësisë, legalizimit dhe transaksioneve të administruara në dosjen e aplikimit.

Të ardhurat mujore neto të familjes nga pagat janë gjithsej 101 400 (njëqind e një mijë e katërqind) lekë, të përbëra nga 57 000 lekë të kryefamiljarit dhe 44 400 lekë të bashkëshortes. Nga dokumentacioni i administruar rezulton se familja i përket komunitetit egjiptian. Gjithashtu, anëtarët e familjes plotësojnë kriterin e moshës për klasifikimin si familje e re, sipas përcaktimeve ligjore dhe dokumentacionit të paraqitur.

Në zbatim të Ligjit nr. 22/2018 "Për strehimin social", i ndryshuar me ligjin nr. 48/2023 dhe VKM nr. 301, datë 15.04.2020, Komisioni vlerësoi se:

Familja plotëson kushtin e strehimit, pasi nuk disponon banesë në pronësi, dhe kushtin ekonomik, duke u klasifikuar si familje me të ardhura të ulëta, sipas dokumentacionit të administruar dhe kritereve të Ligjit nr. 22/2018, "Për strehimin social", të ndryshuar me ligjin nr. 48/2023.

Në zbatim të VKB-së nr. 139, datë 26.11.2025, "Për miratimin e sistemit të pikëzimit për programet e strehimit social", Komisioni aplikoi sistemin e pikëzimit me këtë rezultat:

1. Kushtet e strehimit – nuk disponon banesë në pronësi: 10 pikë;
2. Kushtet familjare – familje e re: 7 pikë;
3. Kushtet sociale – i përket komunitetit egjiptian: 3 pikë;
4. Kushtet ekonomike – të ardhura të ulëta: 10 pikë.

Totali i pikëve: 30 (tridhjetë) pikë.

Në përfundim të shqyrtimit, bazuar në ligjin nr. 22/2018, "Për strehimin social", të ndryshuar, VKM-në nr. 453, datë 03.07.2019, të ndryshuar, VKM-në nr. 301, datë 15.04.2020, si dhe në shkresën nr. 407/53, datë 01.08.2022, të Ministrisë së Ekonomisë, Komisioni i Strehimit vendosi:

1. Të kualifikojë familjen e Z. Ilir Shaban Ahmeti për përfitim nga programi "Banesë me Kosto të Ulët nëpërmjet Subvencionit të Interesave të Kredisë".

2. Të përcaktojë, sipas normave të strehimit dhe dokumentacionit të administruar, tipologjinë e banesës 3+1 dhe vlerën maksimale të kredisë prej 2 835 600 (dy milionë e tetëqind e tridhjetë e pesë mijë e gjashtëqind) lekësh.

Për sa më sipër, propozohet që familja Ahmeti të miratohet si përfituese nga programi "Subvencioni i Interesave të Kredisë", për banesë të tipologjisë 3+1, në përputhje me normat e strehimit, me kufi maksimal kredie në vlerën 2,835,600 lekë.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

	(Emër Mbiemër)	Nënshkrimi	Data
Konceptoi Përgj.Sektori Strehimi :	L. Mullalli		Dt. 20/10/2026
Miratoi Drejtori i Drejtorisë:	J.Sulo		Dt. 20/10/2026

KRYETARI I BASHKISË
Gëzim Topçiu

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALIQ